

## Procesverbal

*Nga mbledhja III (e tretë) e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 13.12.2023*

### *Rend Dite*

#### 1) Shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

**Uran Halimi:** Përshëndetje të nderum delegatë, po fillojmë me Mbledhjen III të jashtëzakonshme, në fakt të 12-tën me radhë për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ku njëherit është propozuar shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Pikë tjetër nuk ka, nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me rendin e ditës? Jetmiri e ka kërkuar fjalën.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje për të gjithë! Na keni thirrë në seancën e katërt të jashtëzakonshme, me të vetmen pikë të rendit të ditës për shkarkimin e kryesuesit. Pikë të cilën edhe në seancën e kaluar e kam kundërshtuar, por do ta kundërshtoj përsëri. Është në të keqen e qytetarëve të Dragashit që të shkarkohet kryesuesi. Asgjë nuk ka të mirë kjo pikë e rendit të ditës dhe nuk ka asgjë të jashtëzakonshme për me e thirrë një seancë të tillë. Seancat e jashtëzakonshme duhet të thirren për gjendje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me të mirën e qytetarëve, e jo në këso rrethana. Edhe një herë po ju kërkoj të gjithëve që të jeni kundër kësaj pike të rendit të ditës, me arsyet të cilat tashmë dihen. Keni thirrë seancë të jashtëzakonshme për shkarkimin e kryesuesit me arsyetimin se kryesuesi ka bërë shkelje të Rregullores, të cilën asnjëherë Ministria nuk e ka kthye që ka shkelje procedurale gjatë mbarëvajtjes së seancave. Për shkelje, kuptohet kush janë ata që bëjnë shkelje të procedurave. Jeni ju ata, të cilën gjë jau u ka vërtetue Ministria, me kthimin e Vendimit prapë. Edhe një herë, kryetar, të kisha kërkuar që ta tërheqësh këtë pikë të rendit të ditës. Edhe del këtu të ju tregosh qytetarëve çfarë pazare je duke bo me asambleistë, veç për me i bo votat për shkarkimin e kryesuesit. U pa në seancën e kaluar reagimi yt ndaj asambleistes së PDK-së, gjithashtu presionin që jau bën asambleistëve të komuniteteve. Edhe një herë ju kërkoj ta anuloni këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ajdini! z.Nedžmidin Sejhdilar e ka kërkuar fjalën.

**Nedžmidin Sejhdilar:** Të nderuar qytetarë, kjo është seanca e katërt e jashtëzakonshme ku mbledhemi për t'ju hequr ju zoti Kryesues nga karrigia ku jeni ulur. Nga sa mund të konkludoj, zoti Kryesues, ju jeni një person shumë i vështirë dhe kjo qeveri nuk ju heq dot as me shumicën e votave. Mendoj se kjo qeveri duhet të merret më shumë me avokatët e saj, të cilët po i futin në rrugë të gabuar. Me shumicën e votave kanë shkelur ligjin dhe sërish Ministria e Vetëqeverisjes Lokale si çdo seancë na i kthen vendimet për rishqyrtim. Sot jemi mbledhur sërish këtu për t'ju votuar mosbesimin. Megjithatë, në përputhje me ftesën që kam marrë si delegat, mund të them sërish se struktura qeverisëse ka shkelur ligjin, sepse derisa të të heqim nga ajo karrige, ti je ende Kryesues. Sipas nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ju duhet të na dërgoni ftesën për seancë, së bashku me petitionin e delegatëve që iniciojnë shkarkimin tuaj. Mirëpo, në ftesë thuhet se na ka ftuar Mehmed Spahiu dhe prisja që ai të ishte në vendin tuaj dhe të udhëheqte seancën. Të nderuar qytetarë, ky pushtet ekzekutiv, së bashku

me satelitët të ti nga Gora, po bëjnë gjithçka për t'i fshehur faktet nga ju dhe opinionin dhe të organizojnë seanca të jashtëzakonshme që ne delegatët të mos pyesim se çfarë po ndodh me projektet, që ata të mos kenë dhe organizimi i një komitet për politikën dhe financat. Nuk do ta përmendi Komisionin për Komunitete, sepse është një komision i uzurpuar, i cili nuk bën asgjë, dhe mbledhjet tona zgjasin jo më shumë se 3 minuta. Është fundviti dhe komisioni i politikës dhe financave nuk mund të diskutojë se ku janë shpenzuar paratë, sepse ky ekzekutiv kërkon vetëm të organizojë seanca të jashtëzakonshme dhe të tërheqë vëmendjen e publikut për shkarkimin e Kryesuesesit të Kuvendit, i cili ka absolutisht nuk ka të bëjë me mirëqenien e qytetarëve. Kryesuesesit i Kuvendit është thjesht si një dirigjent që na jep fjalën dhe kaq. Ky ekzekutiv ende po tenton të uzurpojë organin më të madh legjislativ të komunës, kuvendin, në atë mënyrë që ta largojnë Kryesuesesin nga pozita e Kryesuesesit të kuvendit dhe kështu të marrin një vend tjetër në komisionin për politikë dhe financa dhe më pas. ata do ta kontrollojnë plotësisht edhe atë trup. Pas kësaj, ne nuk do të kemi kontroll se si shpenzohen paratë dhe për çfarë shpenzohen. Të nderuar qytetarë, përveç kësaj, ky pushtet ekzekutiv ka treguar paaftësinë e tij, po t'i japim të gjitha 27 votat këtu, nuk do të dinë ta shkarkojnë Kryesuesesin e Kuvendit. Kjo u tregua edhe në seancën e kaluar. Sa i përket presioneve, këto presione janë evidente. Unë jam i vetmi që e vë në dukje këtu. Këta kolegët e mi duhet të heshtin këtu. Presioni i fundit që ka ndodhur ka qenë presioni i Samidin Xheladinit ndaj nënkryetarit të komunës. Ku është nënkryetari, ai nuk është këtu. Kështu ka ndodhur përdje, megjithëse kam pasur edhe një incident të vogël personalisht me kryetarin e komunës, por nuk ka rëndësi, jam mësuar dhe nuk heq dorë as edhe një milimetër. Të nderuar qytetarë, kjo qeveri organizon seanca të jashtëzakonshme për të larguar vëmendjen nga ai lum në Radesh dhe jo për t'u shpjeguar atyre në Radesh se për çfarë projektesh bëhet fjalë. Dhe cili do të jetë fati i lumit të tyre, ku me të drejtë kanë fjalën, madje kam informacione se i janë drejtuar me peticion autoritetit ekzekutiv. Nuk e di se çfarë lloj informacioni kanë marrë për këtë. Kjo qeveri ekzekutive organizon seanca të jashtëzakonshme me qëllim shkarkimin e Kryesuesesit të këtij kuvendi për arsye se do të largonin vëmendjen nga shëndetësia, e cila është në një kaos katastrofik, ku praktikisht asgjë nuk funksionon. Duhet të largojnë vëmendjen duke organizuar seanca të jashtëzakonshme që ne delegatët të mos marrim përgjigje, çfarë ndodhi me automjetin që blenë në fillim të mandatit të tyre, i cili nuk ecën më shpejt se 35 km/orë. Automjeti i urgjencës. Sido që të ndodhë sot, sa më shumë të kalojë koha, aq më pak ka mbetur nga kjo qeveri. Shpresoj që në zgjedhjet e ardhshme të jeni të vetëdijshëm dhe t'u thoni jo këtyre. Dhe ju Kryesues, në pajtim me nenin 44 të LVL-së, keni të drejtë të plotë që sot ta mbyllni këtë seancë pa votuar sepse ju nuk e thirrret. Ju jeni ende Kryesues i Kuvendit. Është dashur t'ju dërgohej peticioni që të thërrisnit ju seancën dhe jo delegati më i vjetër i këtij kuvendi.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdilar! Fjalën e ka kërkuar z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Përhëndetje për të gjithë! Përhëndetje kryetar, përhëndetje kolegë asambleistë, media dhe ju të pranishëm! Pavarësisht se është një seancë e thirrur për shkarkimin e kryesuesit, unë nuk do të ndalesha shumë te kjo pikë, pasi që kemi shumëçka që të flasim, e kësaj nuk i jap aspak arsye. Kur e them këtë, bazohem në shumë fakte. Njëra prej atyre është që ky është fundi i vitit 2023 dhe qytetarët presin nga ne që në këtë fundvit t'i japim ne të gjitha ato të arriturat apo dështimet të cilat i ka bërë kjo qeverisje, e jo që të merrena me shkarkime. Po besoj se kishte me qenë e arsyeshme që në këtë seancë të fundit, që ne dy seancat e fundit, qoftë të nëntorit e

qoftë të dhjetorit, jemi marrë vetëm me shkarkime. Po besoj që këtu u deshtë të është drejtori i Shëndetësisë, të raportojë çka është bo që tre muaj nuk ka punue EKG-ja në spital, nuk ka punue laborator i analizave, të cilët i kemi detyrue qytetarët që të enden për Prizren. Dhe krejt së fundmi është rregullue, faleminderit shumë që është rregullue, drejtor, por duhet të vijsh këtu dhe të raportosh. Isha ndalë tek drejtori i Arsimit që të është këtu prezent. Çfarë është, drejtor, që në dy-tri shkolla, po përfundon gjysmëvjetori i parë, ne nxemje nuk kemi në këto shkolla. Këtu duhet të jesh, këtu duhet të raportosh. Krej së fundmi, i takon edhe kryetarit që e ka grupin e vet, i ka drejtorët e vet, bashkë me ta të japë sqarim. E, jo të merremi me këto shkarkime. Mua nuk po më duket e rrugës që sot të mbajmë këtë takim për shkarkimin e kryesuesit, pasi që kemi pas shumëçka që të diskutojmë, jo vetëm në këtë seancë, por edhe në seancën paraprake. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Selaj! Fjalën e ka kërkuë z.Mehmet Spahiu.

**Mehmet Spahiu:** Përsëritje kryetar, bashkë me stafin! Përsëritje kryesues, asambleiste dhe asambleistë, media dhe ju qytetarë të nderuar! Kërkoj nga kryesuesi i Asamblesë Komonale që t'i përmbahet rendit të ditës, ngase sot është një pikë e rendit të ditës dhe të mos lëmë hapësira për diskutime tjera. Të jemi shumë të qartë në këtë drejtim. Unë si asambleist më i vjetër kam thirrur këtë seancë, andaj kërkoj, z.kryesues, që t'i përmbahesh rendit të ditës. Kaq!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Spahiu! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? z.Shpetim Hajredini e ka kërkuë fjalën.

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit, i nderuar kryesues! Përsëritje të nderuar kolegë asambleistë, drejtorë dhe ju të pranishëm, qytetarë të nderuar të Dragashit! Seanca e tretë e jashtëzakonshme. Është befasi! Dy seanca i kalojmë për shkarkim të kryesuesit. Kryesues të cilin ju vetë e keni emëruar. Por, natyrisht që kjo është e drejtë e juaja dhe ligjërish keni të drejtë që të na bini këtu, të na thirrni, për t'i përmbushur ato teket e juaja apo ato premtimet të cilat i keni dhënë para se ju të vini këtu edhe të merrni mandatin, ta qeverisni këtë Komunë. Atë të cilën e kam thënë pothuajse në shumë seanca të kaluara, prapë po më duhet ta përsëris edhe një herë, sepse ju po ma mundësoni një gjë të tillë. Kam thënë që para çdo vendimi është mirë që ju të konsultoheni me jurista, me njerëz adekuatë, njerëz të cilët e kuptojnë ligjin, e dinë ligjin. Edhe mos të merrni vendime të ngutshme dhe të na kthehen prapë, dhe prapë mbajmë seancë për të njëjtin vendim. Me të vërtetë kjo është për t'u çuditur me ju, se pse nuk i pranoni këshillat. Dhe kur të merret një vendim, është mirë që të konsultoheni me njerëz adekuatë, që të mos na kthehen vendimet prapë. Një vendim i kthyer prapë, tash i seancës së kaluar – të cilën seancë, unë edhe si shef i GP të PDK-së pata kërku që të shtyhet, për shkak të asaj ngjarje të cilën nuk due ta ritheksoj prapë, por ju nuk e shtytë, e vazhduat, dhe u pa që është e jashtëligjshme. Dhe sot prapë thirret seancë për të njëjtin problem. Kqyr keni kujdes, se po na ktheni prapë edhe një herë, e nuk e di a kemi kohë më edhe një herë me ardhë për këtë çështje. Kemi shumë probleme, shumë çështje më të mira, kemi shumë çështje të cilat janë më me emergjente të cilat duhet t'i diskutojmë ne këtu dhe të cilat kanë ndikim direkt te qytetari. I nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë asambleistë, ju e dini që para disa seancave kena marrë një vendim – nuk po them unanimisht, se nuk po e di saktë nëse kena votuar të gjithë – që t'i falim 100 eurshin e tatimit në pronë për vitin 2023. A nuk kish qenë ma mirë që sot ta kemi një seancë të rregullt dhe të diskutojmë për këtë çështje?! Gjithashtu, dhe ta keni edhe këtë pikë të rendit të ditës, pikën e fundit, shkarkimin e kryesuesit. Nuk ju prishte gjë, ligjërish keni

pas këtë të drejtë. Pse sot ne mos të japim sqarim para qytetarëve, çka ka ndodhur me atë vendim. Unë besoj se kjo kishte qenë shumë më e drejtë. Që ta kemi një seancë të rregullt dhe t'u japim sqarim qytetarëve të cilët kanë prit ndoshta deri sot që do t'u falet ai 100 eursh. Ndoshta sot jo që do ta paguajnë patjetër, por e kanë prapë edhe një gjobë tjetër. Ju keni ardhë me premtimin që keni frikën e Zotit. E, frika e Zotit në këto momente është harruar. Zoti është me ne kur e japim premtimin, por Ai është me ne prapë edhe kur e thyejmë premtimin. Edhe kemi me dhënë llogari. Këtu shumë prej nesh po e marrim politikën, hajt se politika është rrenë, është përfitim edhe kalon. Jo vallahe, s'kalon! Ju garantoj, për çdo fjalë, për çdo vepër që e bëjmë, ne kemi me dhënë llogari para Zotit, po edhe para qytetarëve, se nuk kemi ku i ikim kësaj. Po te qytetarët kalojnë, fitove e s'fitove pas dy vjetëve, ti ke me e jetue jetën, ke me vazhdue. A, para Allahut ke me dhënë llogari. Prandaj kjo – nuk po due ta zgjas tek e fundit, se ju veç keni vendos, votat besoj edhe këtë herë i keni, edhe do ta shkarkoni. Unë në emër të Grupit të PDK-së, si në seancën e kaluar, edhe në këtë seancë ju jap njoftim, që për ju nuk është i mirë, që ne nuk do ta mbështesim shkarkimin e kryesuesit, pasi që arsyetimi të cilin e keni dhënë ju, për ne ai nuk qëndron dhe nuk është i drejtë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Hajredini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? E ke krye, Sejdilar. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën po e marr unë, meqenëse s'ka tjerë.

Patjetër që duhet me e marrë fjalën, edhe pse pak a shumë po më vjen realisht turp të diskutojmë për të katërtën herë shkarkimin e kryesuesit. Shumicën në Kuvend, hera e katërt po shkarkohet kryesuesi. Po besoj që ekzekutivi tashmë e ka pa kush po duhet me u shkarkue këtu. Jeni ju ata që duhet me u shkarkue. Meqenëse po kërkoni shkarkimin e kryesuesit të cilin ju e keni votuar, unë kam të drejtë me e kërkue shkarkimin e kryetarit të cilin na e kemi votue si LVV. I kisha ofrue kryetarit dorëheqjen, me dorëheqje nëse është i gatshëm për me e bo, se realisht, na LVV-ja e kemi votue këtë qeverisje edhe këtë kryetar. Kisha pas qef me e marrë fjalën kryetari, me i thënë nja dy fjalë mas fjalës sime. Kryetar, po besoj që e ke pa sa është fuqia e juaj në raport me një kryesues të LVV-së. Jo rastësisht e keni thirrë seancën e katërt, keni me thirrë prapë seancë, po besoj që s'është kjo e fundit. Mirëpo, pafuqia juaj ju ka sjellë në këtë gjendje ku jeni sot. Jo veç pafuqia, mossinqeriteti, dredhia, tradhtia, dallaverja, nepotizmi, keqpërdorimi edhe gjithçka tjetër me radhë, e sidomos tradhtia e votës së qytetarëve, veçanërisht të votuesve të LVV-së, të cilët me sinqeritetin më të madh ju kanë përkrahë, votu edhe angazhu që ju të vini në pushtet. Këtë e dini edhe ju, edhe të gjithë delegatët, edhe ekzekutivi edhe të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Ajo të cilën ia keni bo LVV-së edhe votuesve të LVV-së, është diçka që jeni t'u e përjetu edhe po ju kthehet boomerang, çdo ditë e më shumë. S'po du me rëndu fjalorin, kemi folë në lidhje me këtë çështje. Për shkak të moshës që e ke, kryetar, jam mundue vazhdimisht me të përkrah, shpeshherë të kam respektue ma shumë se që e ke meritue. Ma shumë për hatër të qytetarëve, sesa për hatër të juaj si udhëheqje komunale. E keni thirrë një seancë muajin që shkoi, për shkarkimin e kryesuesit, arsyeja u konë shkelja e Rregullores së Kuvendit. Shumë është mirë kur ta demantoni një lajm, veçanërisht, e kur ta jepni një arsye, bashkëngjijtani ndonjë fakt bre, se shumë qesharak po i boni do ftesa. Bashkëngjijtani një argument, cila është ajo Rregullore, cilin Nen të Rregullores e ka shkelë kryesuesi. Po të kish shkelë kryesuesi ndonjë rregullore ose ndonjë ligj, na kemi edhe organe më të larta, e dini shumë mirë. Nëse qeverisni me një Komunë, nuk do me thënë që e keni superfuqinë. Në kohë të fushatës keni folë për Zotin, kamerën e Zotit, drejtësi, shpeshherë e ke fut edhe

Sheriatin në fushatë. Po është qaj Zoti që juve po jau pamundëson shkarkimin e kryesuesit. Po më vjen shumë keq, moralisht i shkarkum jam prej prishjes së koalicionit, arsyeja pse s'jam largue prej kësaj pozitës, votën e juaj unë e kam respektue vazhdimisht. Ju më keni votue. S'mundi unë votën e delegatit me e hedhë poshtë, ju kam respektue ma shumë sesa që duhet. E qetash, qat votën që ju e keni përdorë për me m'emëru, jeni bo mish e lakër këtu derisa e keni zgjidhë problemin e zgjedhjes së kryesuesit, deri sa më keni pru në këtë pozitë, edhe qetash hajde ta shkarkojmë kryesuesin. Shkarkimi i kryesuesit – qysh ka thënë z.Myrtezani – s'është bre fundi i botës. Unë i kam hy kësaj fushate m'u konë delegat i Kuvendit Komunal, jo kryesues. Ju më keni bo kryesues. Unë delegat kam me vazhdue m'u konë, se e kam mbështetjen e qytetarëve. Më erdh interesant që z.Myrtezani më ka akuzue edhe te ajo seanca e parë kur ka ardhë. Më ka ofendue personalisht, edhe pse thojke mos e merr personale, e 'na e dimë sa dijsh ti'. Shumë e ulët u konë kjo, se z.Myrtezani unë nuk e kam pas as profesor, as mësues, as koleg të punës, për me konstatue ai personalitetin tem edhe nivelin tem të diturisë. Qytetarët e dinë sa di unë, z.Myrtezani. Këta delegatë këtu e dinë sa di unë, z.Myrtezani. Ata ish-nxënësit e mi, që tash janë studentë shembullorë, prapë e dinë sa di unë. Mandej, te seanca para kësaj të fundit, më akuzove personalisht, mandej thaje jo mos e merr prapë personale. Qysh mundi unë mos me e marrë diçka personale, kur ti personalisht me mu po merresh. Të kam amnestue te e para, për shkak të lidhjeve familjare që na i kemi, për shkak të qytetarëve, mos me ra në pozitë qaq të ulët, meqenëse ti raje, unë s'kam pas arsye me ra në qat nivel. Mirëpo, te kjo e dyta unë i kam ftue edhe zyrtarisht organet kompetente, me marrë vesh, se jam shumë kurioz me e ditë kush të ka fye e të ka sha ty, e të ka shantazhue e kërcënue, qysh edhe ti e thaje. Nuk e pashë ndonjë veprim të organeve kompetente, tash e tutje do të bëj veprime personalisht edhe në kuadër të partisë të cilën unë e përfaqësoj këtu. Tash, sa i përket Rregullores që unë vazhdimisht e paskam shkelë, unë ju ftoj me m'kallxue dikush prej juve cilin Nen, cilën pikë të Rregullores e kam shkelë? Nëse jeni të gatshëm, mundeni me e çue dorën. Cili është ai Nen i Rregullores që unë sistematikisht e kam shkelë, sistematikisht, jo sitematikisht, sistematikisht e kam shkelë. Urdhëroni, ma thoni ju delegatë të nderum! Qetash, të Rregullorja e Kuvendit, s'ka shkelje këtu, e keni të argumentum. E kemi na Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, të cilin na në fakt e kemi udhërrëfyes me të cilin na veprojmë si Kuvend. Sa për informacion, te Neni 44, pika 44.1, është fjala për takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës. Thotë që 'takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku 1/3-ta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo me kërkesë të kryetarit. Domethënë, ju i keni nënshkrimet, mirëpo 'apo me kërkesë të kryetarit'. Kryetari mu s'më ka pru kërkesë për me e thirrë këtë seancë të jashtëzakonshme. Nëse po, kryetar, del më demanto. Mirëpo, me argumente, në momentin kur ti nuk më ke kontaktue mu, edhe e ka thirrë seancën z.Mehmet Spahiu, ka bërë shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. z.Spahiu, nëse e ke gjet Nenin 44, pika 1, a jam gabim a po thotë qashtu? Andaj, shkelje të Rregullores pa e shkelë, me shkelje të Ligjit, të argumentuar, unë nuk lejoj. E shpalli këtë seancë të mbyllur! Mirë u pafshim në seancat e radhës!

**Mehmet Spahiu:** Të nderuar, fillimisht po e shikojmë a e kemi kuorumin për të vazhduar seancën. Konstatojmë që kuorumin e kemi dhe mund të vazhdojmë, 15 delegatë janë të pranishëm. Do të thotë, konstatojmë se e kemi

kuorumin për të vazhduar seancën e sotit. Për sot kemi vetëm një pikë të rendit të ditës: Shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Pyes të pranishmit, a pajtoheni me rendin e ditës? Kjo është seancë e jashtëzakonshme dhe nuk ka pika shtesë. Kërkoj miratimin e juaj, a pajtoheni me këtë rend dite? Kush është pro? Kundër a ka dikush? Abstenim? Nuk ka. Me 15 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, kaon rendi i ditës. Tash përcaktohem për mënyrën e votimit. Me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit, parashihet votimi i fshehtë, por ne mund të vendosim si Asamble edhe me votim të hapur. Nuk është e përcaktuar me Ligj, domethënë, por ne tash duhet të përcaktohem për votimin e hapur. Nëse ka mundësi, vetëm një pauzë të vogël! Përcaktohem a jemi për vota të hapura, apo të mbyllura. Kush është pro votave të hapura? Kundër a ka? Abstenim? Nuk ka. 15 vota janë pro votimit të hapur, zero kundër dhe zero abstenim. Kalojmë në pikën e rendit të ditës. Kush është pro shkarkimit të kryesuesit të deritanishëm të Asamblesë Komunale, z.Uran Halimi? Kush është kundër? Abstenim? Konstatojmë se 15 vota janë pro shkarkimit, zero kundër dhe zero abstenim. Kaloi kjo pikë e rendit të ditës. Ndonjë pikë tjetër s'kemi. Konstatojmë se seanca e sotme është kryer. Mirë u pafshim në takimet e radhës!